

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (DAP) PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar reformën e administratës publike dhe zbatimin e legjislacionit të ri për shërbimin civil një nga përparësitë dhe sfidat kryesore për anëtarësimin të plotë të Shqipërisë në BE;

- Duke shprehur angazhimin e tij për një monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të ligjit të ri për shërbimin civil;

- Duke vlerësuar rolin e DAP-it si institucioni publik qendror përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore, hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve në fushën e administratës publike në tërësi;

- Duke mbështetur misionin e DAP-it për të përmbushur objektivat strategjike institucionale, respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore për administrimin e një shërbimi civil bazuar në efikasitet, konkurrencën e lirë e të bazuar në merita, transparencën dhe depolitizimin sipas standardeve të përgjithshme të menaxhimit dhe përgjegjësitë për të, në përputhje me parimet themelore të “hapësirës administrative europiane”;

Konstaton se veprimtaria e DAP-it për vitin 2013 është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Në kryerjen e veprimtarisë institucionale të ndarë ndërmjet dy periudhave janar gusht 2013 dhe shtator-dhjetor 2013, të cilat korrespondojnë me ndryshimet politike për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013;

- Në hartimin dhe miratimin e kuadrit të ri ligjor/nënligjor për zbatimin e legjislacionit të ri për shërbimin civil;

- Në angazhimin institucional për hartimin e strategjisë ndërsektoriale të reformës në administratën publike 2014-2020 ;

- Në raportimet periodike pranë organizmave dhe grupeve të posaçëm BE –Shqipëri për zbatimin e rekomandimeve të progres raporteve të vitit 2013 dhe në vijim për ecurinë e reformës në administratën publike dhe plotësimin të standardeve europiane në të;

- Në përmbushjen e detyrimeve ligjore bazë që parashikonte kuadri ligjor i mëparshëm në fuqi.

Kuvendi vëren se:

- Angazhimi i DAP-it, për të hartuar ligjin e ri për nëpunësin civil kishte mangësi profesionale , të cilat shkaktuan vonesa në zgjidhjen e kundërshtive me ligjin Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;

- Ky institucion nuk ka përmbushur funksionet ligjore lidhur me hartimin e akteve nënligjore të domosdoshme kërkesë e ligjit 152/2013” Për nëpunësin civil”, të miratuar me konsensus politik. Si rrjedhojë, nga kjo mospërmbushje, u shkaktuan vonesa në fillimin e zbatimit të ligjit 152/2013 duke e bërë atë joefektiv.

- Gjatë periudhës para dhe paszgjedhore, aktiviteti i DAP-it rezultoi thuajse inekzistent;

- DAP-i nuk ka kryer reformë reale në fushën e pagave siç raportohet;

- Trajnimet e planifikuara të administratës publike rezultojnë formale;

- Ka munguar angazhimi ligjor i Kuvendit për të vlerësuar dhe monitoruar zbatimin e ligjit të shërbimin civil dhe problematikat e shfaqura në institucionet e administratës qendrore.

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2013, aktiviteti i DAP-it ka konsistuar në:

- Realizimin e 40 për qind të të gjitha aktiviteteve trajnuese të planifikuara për vitin 2013;

- Përgatitjen intensive për hartimin e një sërë aktesh nënligjore të pakryera nga DAP-i pararendës, si dhe përgatitja për rishikimin e legjislacionit për shërbimin civil;

- Përcaktimin e fushave dhe veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie të linjës dhe ministrisë së shtetit në kuadër të detyrimeve për zbatueshmërinë e ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore;

- Intensifikimin e procedurave të bashkëpunimit me institucionet e tjera përgjegjëse ligjzbatuese të administratës publike, këshillimit e shkëmbimit të informacionit të nevojshëm më to;

- Përgatitjen intensive për finalizimin dhe nxjerrjen e 10 akteve nënligjore dhe 3 udhëzuesve, në zbatim të ligjit të ri të shërbimit civil nr. 152/2013, të cilat u miratuan në fillim të vitit 2014;

- Rivendosjen e bashkëpunimit me “Sigmën” për vlerësimin e projekt- strategjisë së Reformës në

Administratën Publike 2014-2020 dhe hartimin e metodologjisë së vlerësimit të kësaj strategjie;

- Fokusimin e veprimtarisë së tij në funksion të planit të masave dhe zbatimit konkret të tyre sipas rekomandimeve të progresraportit të BE-së të vitit 2013.

Kuvendi i Shqipërisë përshëndet punën e DAP-it që në vetëm tre muaj nga formimi i Qeverisë së re, strukturat e reja të miratuara, eliminuan hallkat e tepërta në administratë dhe forcuan drejtimit prioritar të administrimit si integrimin europian, planifikimin strategjik, sektorin e luftës kundër korrupsionit, njësinë e jetësimit të prioritetëve, si dhe të teknologjisë së informacionit.

Kuvendi kërkon që DAP-i për vitin 2014:

I. Të zhvillojë aktivitetin e tij institucional duke u përqendruar në kërkesat e progres raporteve të BE-së dhe në konsulencën e organizmave ndërkombëtarë që mbështetin këtë institucion;

II. Të përmbushë objektivat kryesorë lidhur me:

- Hartimin dhe miratimin brenda vitit 2014 të strategjisë ndërsektoriale të reformës në administratës publike 2014-2020;

- Përfundimin e hartimit brenda vitit të të gjitha akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;

- Zbatimin e unifikuar të ligjit përmes një regjimi të njëjtë juridik në të gjitha institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit, duke sjellë zbatimin në praktikë të instituteve të tjera të ligjit për një sistem karriere në të gjithë fushën e veprimit të shërbimit civil;

- Kthimin e besimit të publikut në procesin e marrjes në punë duke u bazuar në objektivitetin, transparencën, barazinë dhe cilësinë e sistemit të konkurrimit;

- Fuqizimin e rolit të DAP-it dhe vullnetit të tij për të përmbushur funksionet dhe përgjegjësitë e tij si një institucion përgjegjës për politikën shtetërore në fushën e shërbimit civil me qëllim për të fuqizuar këtë shërbim në tërësi;

- Shtimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit të DAP-it me njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore përmes udhëzimeve dhe akteve administrative për parandalimin e shkeljeve ligjore dhe ndërtimin e një shërbimi civil profesional, të qëndrueshëm me integritet;

- Shtimin e raportimeve periodike dhe raporte të posaçme për Kuvendin e Shqipërisë lidhur me çështje të caktuara gjatë ecurisë së zbatimit të reformës në administratën publike;

- Fuqizimin e rolit menaxhues dhe mbikëqyrës të DAP-it, si dhe vullnetit për të siguruar përgjegjësitë e tij dhe zbatuar funksionet e tij në cilësinë e një institucioni përgjegjës për politikën shtetërore në fushën e shërbimit civil;

- Saktësimin në ligj të përgjegjësisë dhe statusit të varësisë institucionale të DAP-it për ndryshime të nevojshme ligjore të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”;

- Reformimin strukturor të DAP-it, duke forcuar kapacitetin, burimet, instrumentet e nevojshme dhe të duhura ligjore në përshtatje me ligjin e ri për shërbimin civil;

- Përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në sistemin e trajnimit, kurrikulat e hartuara nga ASPA, si mekanizma kryesorë në zhvillimin e karrierës të nëpunësve civilë, duke realizuar trajnime efikase për të gjitha nivelet sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil dhe standardeve europiane;

- Përfundimin e projektit për zgjerimin dhe modernizimin e Sistemit Informatik të Menxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS);

- Zhvillimin dhe pasurimin e faqes zyrtare të DAP-it, duke publikuar në mënyrë të përditësuar çdo informacion të nevojshëm për publikun dhe institucionet.

KRYETARI

Ilir Meta

Miraturar në datën 31.7.2014